



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2024-27

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Data: 3 tetor 2024

Administratore: Fidelma Donlon

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese:

Gjykatës Vidar Stensland
Gjykatës Roumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Salih Mustafës:
Julius von Bone

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ("Ligji") dhe rregullave 3 dhe 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi parashtrimin, Kërkesë Referuese në Çështjen Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Salih Mustafa të Garantuara nga Nenet 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me Shtojcat 1-7 Publike ("Kërkesa Referuese").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues I shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin, ndër të tjera, e shpalli z. Salih Mustafa fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e shpalli të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor.² Trupi Gjykues e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.³

2. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi Aktgjykimin e Apelit me të cilin la në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por miratoi, pjesërisht, apelin e z. Mustafa lidhur me dënimin e tij.⁴ Për këtë qëllim, Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Mustafa

¹ F00001, Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Salih Mustafa të Garantuara nga Nenet 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me Shtojcat 1-7 Publike, 27 shtator 2024.

² KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykim, 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023 dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 qershor 2023.

³ Aktgjykimi, para. 831.

⁴ KSC-CA-2023-02/F00038, Aktgjykimi i Apelit, 14 dhjetor 2023 (konfidencial), para. 484. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të Apelit u lëshua më të njëjtën ditë (KSC-CA-2023-02/F00038/RED).

në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁵

3. Më 14 mars 2024, z. Mustafa dorëzoi Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat 1 dhe 2 Konfidenciale në Bazë të Nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores.⁶

4. Më 29 korrik 2024, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, me të cilin, ndër të tjera, anuloi Aktgjykimin e Apelit vetëm në lidhje me dënimin e z. Mustafa dhe e ktheu për vendim të ri në lidhje me dënimin e tij në bazë të rregullës 194(1)(b) të Rregullores.⁷

5. Më 10 shtator 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Vendimin për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën, me të cilin uli dënimin e z. Mustafa në 15 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁸

6. Më 27 shtator 2024, z. Mustafa dorëzoi Kërkesën Referuese.

II. CAKTIMI

7. Në bazë të nenit 33(3) të Ligjit, pas parashtrimit të kërkesës referuese në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK"), Kryetarja cakton tre gjykatës të DHSGJK-së. Në rast se njëri nga këta gjykatës nuk është në dispozicion për kryerjen e detyrës, Kryetarja cakton një gjykatës kushtetues rezervë.

8. Kryetarja konstaton se një nga tre gjykatësit e DHSGJK-së nuk është në dispozicion për kryerjen e detyrës. Rrjedhimisht, Kryetarja cakton gjykatësin kushtetues rezervë në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit dhe rregullave 3 dhe 4(2) të Rregullores për

⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

⁶ KSC-SC-2024-02/F00011, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2 në bazë të Nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores, 14 mars 2024.

⁷ KSC-SC-2024-02/F000018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024, para. 112.

⁸ KSC-CA-2023-02/F00045, Vendim për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën, 10 shtator 2024, para. 28.

Caktimin e Gjykatësve.

PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON

Gjykatësin Vidar Stensland

Gjykatësin Roumen Nenkov

Gjykatësen Romina Inkuti

në Panel të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi Kërkesën Referuese.

____/nënshkrimi/____

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E enjte, 3 tetor 2024

Në Hagë, Holandë